



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



BULETINI DITOR I FSSHM-së

PËRMBLEDHJE INFORMACIONESH NGA LËMIA E SHËNDETËSISË TË MARRA NGA SHTYPI DITOR DHE MEDIUMET ELEKTRONIKE

04 Shkurt 2016



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Sot, Dita botërore për luftë kundër karcinomit

Shkup, 4 shkurt - Në Maqedoni sot shënohet 4 shkurti - Dita botërore për luftë kundër karcinomit, e cila këtë vit zbatohet nën sloganin "Ne mundemi, unë mundem" dhe bën thirrje në inkuadrim aktiv të individëve, bashkësisë dhe institucioneve kompetente me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të pasojave nga paraqitja e karcinomit.

Fushata fokusohet në informim dhe edukim për vetëdije të rritur për parandalimin e karcinomit, sigurimin e qasjes përkatëse deri te shërbimet shëndetësore, sigurimin e mjedisit të shëndetshëm jetësor dhe të bëhet thirrje për avancimin e politikave në raport me këtë çështje.

Një nga sferat e fushatës është sigurimi i qasjes deri te shërbimet shëndetësore, ndërsa rol kryesor në luftën kundër karcinomit paraqesin shërbimet parandaluese shëndetësore. Sipas Deklaratës botërore për karcinom, çdo vend duhet të sigurojë skringing të popullatës për detektim të hershëm të karcinomëve, për të cilat ekzistojnë skringing metoda, duke përfshirë edhe karcinomin në kancerin e qafës së mitrës dhe karcinomin në gji. Me vendosjen e këtyre metodave dukshëm zvogëlohet shkalla e vdekshmërisë.

Në Maqedoni mesatarisht në vit nga karcinomi në gji vdesin rreth 280 gra, ndërsa nga karcinomi në qafën e mitrës rreth 30 gra, edhe krahas asaj që dy llojet e karcinomit munden me kohë të zbulohen dhe shërohen.

Shoqata për luftë kundër kancerit "Borka-për çdo ditë të re" nga Shkupi me rastin e Ditës botërore për luftë kundër karcinomit do të lansojë ueb-fushatë me informacione për metodat e parandalimit nga kanceri si sëmundje potenciale shëruese dhe shtypje të afisheve me informacionet bazë për qytetarët, ndarje të informacioneve me karakter publik për parandalim, zvogëlim të rrezikut dhe trajtim të kësaj sëmundje përmes ueb portalit të Shoqatës dhe ueb aplikacioneve fb, tuitër dhe ngjashëm.

Afishet do t'i shpërndajnë vullnetarë në Shkup dhe në qytet nëpër Maqedoni ku Shoqata ka filiale.



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks: 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



Aksion i dhurimit të gjakut në Stacionin policor Kërçovë



Në hapësirat e Stacionit Policor Kërçovë sot u zbatua aksioni i dhurimit të gjakut, në të cilën u përfshinë pjesëtarët e shërbimit policor...

Aktiviteti humanitar paraqet vazhdim të bashkëpunimit tradicional që SP Kërçovë e ka me organizatën komunale të Kryqit të Kuq Kërçovë dhe Institutin për mjekësi transfuzionale të RM-së.

"Në këtë mënyrë edhe pjesëtarët e policisë japin kontribut aktiv në promovimin e dhurimit të gjakut si vlerë njerëzore humanitare", thonë nga organizata komunale e Kryqit të Kuq Kërçovë. /Mia

Dita botërore për luftë kundër karcinomit



Në Maqedoni sot shënohet 4 shkurti - Dita botërore për luftë kundër karcinomit, e cila këtë vit zbatohet nën sloganin "Ne mundemi, unë mundem" dhe bën thirrje në inkuadrim aktiv të individëve, bashkësisë dhe institucioneve kompetente me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të pasojave nga paraqitja e karcinomit...

Fushata fokusohet në informim dhe edukim për vetëdije të rritur për parandalimin e karcinomit, sigurimin e qasjes përkatëse deri te shërbimet shëndetësore, sigurimin e mjedisit të shëndetshëm jetësor dhe të bëhet thirrje për avancimin e politikave në raport me këtë çështje. Një nga sferat e fushatës është sigurimi i qasjes deri te shërbimet shëndetësore, ndërsa rol kryesor në luftën kundër karcinomit paraqesin shërbimet parandaluese shëndetësore. Sipas Deklaratës botërore për karcinom, çdo vend duhet të sigurojë skringing të popullatës për detektim të hershëm të karcinomëve, për të cilat ekzistojnë skringing metoda, duke përfshirë edhe karcinomin në kancerin e qafës së mitrës dhe karcinomin në gji. Me vendosjen e këtyre metodave dukshëm zvogëlohet shkalla e vdekshmërisë. Në Maqedoni mesatarisht në vit nga karcinomi në gji vdesin rreth 280 gra, ndërsa nga karcinomi në qafën e mitrës rreth 30 gra, edhe krahas asaj që dy llojet e karcinomit mundën me kohë të zbulohen dhe shërohen. Shoqata për luftë kundër kancerit "Borka-për çdo ditë të re" nga Shkupi me rastin e Ditës botërore për luftë kundër karcinomit do të lansojë ueb-fushatë me informacione për metodat e parandalimit nga kanceri si sëmundje potenciale shëruese dhe shtypje të afisheve me informacionet bazë për qytetarët, ndarje të



FONDI PËR SIGURIM
SHËNDETSOR I REPUBLIKËS
SË MAQEDONISË

www.fzo.org.mk

Adresa: Bulevardi Maqedonia nr.5, 1000 Shkup
Tel: 02 3289 054
Qendra: 02 3289 000
Faks : 02 3289 048
E-mail: info@fzo.org.mk



informacioneve me karakter publik për parandalim, zvogëlim të rrezikut dhe trajtim të kësaj sëmundje përmes ueb portalit të Shoqatës dhe ueb aplikacioneve fb, tuitër dhe ngjashëm.

Afishet do t'i shpërndajnë vullnetarë në Shkup dhe në qytet nëpër Maqedoni ku Shoqata ka filiale. (mia.mk)

Brazili i shpall luftë virusit Zika



Presidentja e Brazilit, Dilma Rousseff, ka shpallur luftë kundër mushkonjave që shkaktojnë virusin Zika...

Në një mesazh televiziv drejtuar kombit, ajo ka thënë se dita e mobilizimit kombëtar do të mbahet të shtunën, kur mijëra ushtarë dhe punonjës shtetërorë do të përpiqen të zhdukin insektet në shtëpitë dhe zyrat e tyre.

Rousseff ka thënë se shumica e mushkonjave shumohen në ose pranë shtëpive të banueshme.

Virusi Zika bën që foshnjat të lindin me tru të pazhvilluar.

Brazili ka parë shpërthim masiv të këtij virusi, i cili është duke u përhapur në të dyja Amerikat.

Organizata Botërore e Shëndetësisë e ka shpallur atë emergjencë globale shëndetësore.

OBSH ka shfaqur po ashtu shqetësim nga raportet se virusi Zika është transmetuar seksualisht në Teksas të Shteteve të Bashkuara. (REL)